



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:074871  
Datë: 27.02.2024  
Numri i dokumentit: 05381209

**CA.nr.1327/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare, Kujtim Pasuli dhe Burim Shala anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësve-propozuesve N., dhe S.G., nga Prishtina, të cilat me autorizim i përfaqëson M.P., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit-kundërshtarit të propozimit A.G., nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson I.M., avokat nga Prishtina, lidhur me padinë për vërtetim pronësie në bazë të trashëgimisë, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i propozuesve të sigurimit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1518/2022 të datës 27.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.02.2024 mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e propozuesve N., dhe S.G., nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1518/2022 të datës 27.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, C.nr.1518/2022 të datës 27.12.2023, ka vendosur si vijon:

*‘I. REFUZOHET propozimi i paditësve - propozuesve të masës së sigurimit N.G., dhe S.G., me të cilin ka kërkuar nga kjo gjykatë, që të caktohet masa e sigurimit, me të cilën ti ndalohet të paditurit - kundërshtarit të masës së sigurimit A.G., të ndërmarr çfarëdo veprimi juridik për të*

*tjetërsuar, për të lidhur kontratë me ndonjë palë të tretë për shitblerjen, për ti dhuruar, dhënë me qira apo shfrytëzim tjetër, si dhe ti fsheh, ngarkoj me hipotekë, servitut apo çfarëdo ngarkese tjetër, barrë sendore apo barrë personale, në dobi të personave të tretë si dhe të ndërmarr ndonjë aktivitet tjetër për ndryshimin e gjendjes faktike për ngastrën kadastrale me numër P-XXXXX-XXXXX-0 e cila gjendet në Prishtinë në rrugën “Z..... S.....” nr.XX ku është i ndërtuar objekti me Etazhe B+P+7 me S=891m<sup>2</sup>, ku 1/3 e kësaj sipërfaqeje është S=519 m<sup>2</sup>, si bazë përdhese, pronare i secilës figuron i padituri-kundërshtari i sigurimit, mbi të cilën sipërfaqe është kërkuar caktimi i masës së sigurimit të kërkesë padisë.*

*II. Procedura në këtë çështje juridike do të vazhdohet sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe në pajtim me planin e punës së gjykatës’.*

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar propozuesve, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e propozuesit të masës së sigurimit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në riprocedurë dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se :

*-Ankesa e paditësve-propozuesve të masës së sigurimit, është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditëset-propozueset e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar padi me datë 14.04.2022, për vërtetimin e pronësisë nga baza e trashëgimit, bashkë me propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të propozueseve, me aktvendimin C.nr.1518/2022 të datës 07.11.2022, e ka aprovuar propozimin e propozuesesve, duke vendosur si në dispozitiv të tij. Gjykata e Apelit në Prishtinë duke vepruar sipas ankesës së kundërshtarëve të propozimit, me aktvendimin Ac.nr.407/2023, të datës 06.02.2023, aktvendimin ankimor e ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer në riprocedurë, me vërejtjet si në aktvendim.

Në riprocedim të çështjes i autorizuari i propozueseve duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës të shkallës më të lartë, me parashtrësën e datës 20.11.2023, ka rregulluar propozimin për caktimin e masës së sigurimit të kërkesë padisë në aspektin objektiv dhe subjektiv duke e hequr nga propozimi Naim Gashin. Me parashtrësën e rregulluar propozueset kanë kërkuar nga që t’i ndalohet kundërshtarit të sigurimit Asdren Gashi, të ndërmarr çfarëdo veprimi juridik për të tjetërsuar, për të lidhur kontratë me ndonjë palë të tretë për shitblerjen, për ti dhuruar, dhënë me qira apo shfrytëzim tjetër, si dhe ti fsheh, ngarkoj me hipotekë, servitut apo çfarëdo ngarkese tjetër, barrë sendore apo barrë personale, në dobi të personave të tretë si dhe të ndërmarr ndonjë aktivitet

tjetër për ndryshimin e gjendjes faktike për ngastrën kadastrale me numër P-XXXXX-XXXX-0 e cila gjendet në Prishtinë në rrugën “Z..... S.....” nr.XX ku është i ndërtuar objekti me Etazhe B+P+7 me S=891m<sup>2</sup>, ku 1/3 e kësaj sipërfaqeje është S=519 m<sup>2</sup>, si bazë përdhese, pronare i secilës figuron i padituri-kundërshtari i sigurimit, mbi të cilën sipërfaqe është kërkuar caktimi i masës së sigurimit të kërkesë padisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të rregulluar për caktimin e masës së sigurimit, ka mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e propozimit për caktimin e masës së sigurisë me datën 22.12.2023, dhe pas analizimit të tërësishëm të provave, me aktvendimin C.nr.1518/2022 të datë 27.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozueseve për caktimin e masës së sigurimit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ka theksuar se gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore dhe ka konstatuar se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, me provat e ofruara me anë të padisë dhe propozimit për caktimin e masës së sigurimit, propozueset e masës së sigurimit e kanë bërë të besueshme për gjykatën kërkesën e tyre, respektivisht e kanë bërë të besueshme të drejtën subjektive të tyre, mirëpo nuk e kanë bërë të besueshme rrezikun se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të pamundësoje apo vështirësoje dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do të ndryshonte gjendja ekzistuese e gjërave, që në këtë rast kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurisë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, kështu që propozueset e masës kanë dështuar që ta bëjnë të besueshëm faktin se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së këtillë-pala kundërshtare do të mund ta pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesve të sigurimit. Për mënyrën e vendosjes si në aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me dispozitën e nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se “*Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit*”. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë.

Meqenëse, aktvendimi ankimor përmban dispozitiv të kuptueshëm, ndërsa në arsyetim janë paraqit arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet të cilat kanë qenë me rëndësi

për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, për këtë arsye thënie e propozueseve të sigurimit lidhur me atë se aktvendimi ankimor është rrjedhojë e shkeljeve qenësore nga dispozitat e nenit 182 par.1 dhe 182 par.2, pika n) të LPK-së, janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se nga provat në shkresat e lëndës ka rezultuar se propozueset e sigurimit në masë të mjaftueshme e kanë bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të drejtën e tyre subjektive, mirëpo nuk e kanë argumentuar faktin se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës, për shkak të mundësisë së bartjes apo transferimit të pronës nga ana e kundërshtarit të sigurimit, po ashtu nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do ta mbështeste këtë pretendim. Gjykata e Apelit vlerëson se në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të propozueseve të sigurimit lidhur me rrezikun e mundshëm që prona të tjetërsohet apo të ndryshohet gjendja faktike dhe propozuesit do t'i pamundësohet realizimi i të drejtës për vërtetimin faktit, pa e prejudikuar përfundimin meritore të çështjes, në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se caktimi i masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që me ndryshimin e rrethanave në secilën fazë të procedurës, pala propozuese të mos ketë të drejtë të bëjë sërish propozim për caktimin e masës së sigurisë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të saj subjektive, pasi që një mundësi të tillë e lejojnë dispozitat ligjore të LPK-së.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merre një vendim ndryshe.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CA.nr.1327/2024, me datë 27.02.2024**

**Kryetare e kolegjit**  
**Naime Ahmeti d.v,**